



Datë: 23.07.2025
Numër Protokolli: 5042/2025

A.nr.1081/2025

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës-Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave në përbërje nga: Eshref Shabani, kryetar, Ardita Haxhnikaj – Demi dhe Malsore Gashi Bajraktari, anëtarë, me Rushit Kajtazi, në cilësinë e procesmbajtëses, në procedurë sipas ankesës me numër A.nr. 1081/2025, të datës 05.06.2025, të parashtruar nga ankuesi E.R, kundër organit të punësimit Ministra e Punëve të Jashtme dhe Diasporës, në çështjen juridike” *Masë Disiplinore*”, duke vepruar në pajtim me nenin 6 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1, nenin 16 paragrafi 3 dhe nenin 18 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1 të Ligjit Nr. 06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me Ligjin Nr.08/L-180 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës dhe Rregulloren Nr.02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, me datë 23.07.2025, mori këtë:

V E N D I M

I. Refuzohet si e pabazuar ankesa A.nr. 1081/2025, e datës 05.06.2025, e parashtruar nga ankuesi E.R.

II. Mbetet në fuqi, Vërejtja me shkrim me numër 1718, e datës 07.05.2025, i Sekretarit të Përgjithshëm të Ministrisë së Punëve të Jashtme dhe Diasporës.

A r s y e t i m

Nëpunësi civil E.R (në tekstin e mëtejme referuar: Ankues) me datë 05.06.2025, ka parashtruar ankesë në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, kundër vërejtjes me shkrim me numër 1718, të datës 07.05.2025, të nxjerr nga Sekretari i Përgjithshëm të Ministrisë së Punëve të Jashtme dhe Diasporës.

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës (në tekstin e mëtejme referuar: Këshilli) bazuar në dispozitat e Rregullores Nr.02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave, më datë 13.06.2025, ka proceduar kërkesën për përgjigje në ankesë tek Ministria e Punëve të Jashtme dhe Diasporës, ndërsa kjo e fundit, më datë 16.06.2025 ka përcjellë shkresat e lëndës lidhur me çështjen ankimore.

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave administroi këto prova: Ankesën A.Nr.3795/2025 të datës 05.06.2025; drejtuar Këshillit të Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës; Vërejtjen me shkrim me numër 1718, të datës 07.05.2025, të Sekretarit të Përgjithshëm të Ministrisë së Punëve të Jashtme dhe Diasporës; Emalin e datës 14.04.2025, dërguar nga E.R, për Ambasadën e Republikës së Italisë; Notë Verbale e datës muajit prill të vitit 2025;Emaili i datës

10.04.2025; Notë Verbale e datës 10.04.2025, e lëshuar nga Ambasada e Republikës së Italisë; Emalin e datës 14.04.2025, dërguar nga E.R, për N.Sh; Kopjen e letërnjoftimit për ankuesin; Kërkesë për përgjigje në ankesë e datës 13.06.2025, dërguar nga R.K, për H.B; Përgjigjen në ankesë me numër protokolli 1081/2025, e datës 17.06.2025; Emalin e datës 15.04.2025, dërguar nga N.Sh për I.M; Akt Emërimi me numër protokolli 5576, i datës 22.10.2024, për E.R; Kërkesën me numër protokolli 900, të datës 01.06.2023; Përshkrimin e detyrave të punës për pozitën ‘‘ Zyrtar i Misionit Diplomatik’’; Emalin e datës 01.04.2025, dërguar nga E.R për I.M, për Ambasadën e Republikës së Italisë; Emalin e datës 14.04.2025, dërguar nga E.R për I.M, për N.Sh.

Kolegji i Këshillit pas shqyrtimit dhe analizimit të shkresave të lëndës të dorëzuara nga palët në procedurë si dhe pretendimeve ankimore të ankuesit, ka gjetur së ankesa është e pabazuar, sepse:

Nga administrimi i provave të lëndës, Kolegji i Këshillit, ka gjetur se ankuesi sipas Aktit të Emërimit me numër protokolli Nr. 5576 të datës 22.10.2024, është i punësuar në pozitën ‘‘ Zyrtar i Misionit Diplomatik, Departamenti për NATO dhe Politika të Sigurisë, në Ministrinë e Punëve të Jashtme dhe Diasporës.

Tutje Sekretari i Përgjithshëm i Ministrisë së Punëve të Jashtme dhe Diasporës, përmes vendimit me numër 1718 të datës 07.05.2025, ankuesit i ka shqiptuar masën disiplinore ‘‘ vërtetje me shkrim’’, me arsyetim së ankuesi me datën 28.03.2025, përmes emailit ju ka drejtuar Ambasadës së Republikës Italiane, për procesin e aplikimit për viza akreditim në ambasadë, po ashtu me datë 14.04.2025, ka vazhduar komunikim përmes emailit me Ambasadën e Republikës Italiane, në Prishtinë për krijimin e një pozite të re diplomatike në favorin e tij dhe se z. E.R ka ndërmarr veprime të papërgjegjshme institucionale duke adresuar komunikim zyrtar drejtpërdrejtë jashtë hierarkisë dhe kompetencës së pacaktuar pa ndjekur procedurat dhe lidhje zyrtare të komunikimit nga Ministria e Punëve të Jashtme dhe Diasporës.

Ankuesi E.R, i pakënaqur me vërejtjen me shkrim me numër 1718, të datës 07.05.2025, të Sekretarit të Përgjithshëm të Ministrisë së Punëve të Jashtme dhe Diasporës, me datë 05.06.2025 parashtroi ankesë në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil, me pretendimet ankimore se me datën 07.05.2025, kam pranuar vendimin për shqiptimin e masës disiplinore Vërejtje me shkrim me numër referencë Ref. 217/2025, të datës 07.05.2025, Sekretarit të Përgjithshëm të Ministrisë së Punëve të Jashtme dhe Diasporës, deh se në arsyetimin e kësaj vërejtje theksohet se emaili i datës 28.03.2025, drejtuar Ambasadës së Republikës Italiane, në Prishtinë për procedimin e aplikimit për viza.

Bazuar në këtë Kolegji i Këshillit, ka analizuar dispozitat e Ligjit Nr. 08/L-197 për Zyrtarët Publikë, respektivisht nenin 57, paragrafi 1.3, ku përcaktohet se; 1. *Masat disiplinore, të cilat mund të shqiptohen ndaj nëpunësve/it civil për shkelje të lehta janë: 1.3. vërejtje me shkrim*, ndërlidhur me nenin 58, paragrafi 1, ku përcaktohet se; 1. *Masat disiplinore për shkeljet e lehta shqiptohen nga mbikëqyrësi/i i drejtpërdrejtë dhe/apo nga udhëheqësi/i më i lartë administrativ’’, si dhe dispozitat ligjore të Rregullores (QRK) nr. 01/2024 për Disiplinën e Nëpunësve Civil, respektivisht nenin 15, paragrafi 1,2, nen paragrafi 2.3, ku përcaktohet se; 1. *Masat disiplinore shqiptohen në raport të drejtë me shkeljen e kryer. 2. Masat disiplinore, të cilat mund të shqiptohen ndaj nëpunësit civil për shkelje të lehta janë: 2.3. vërejtje me shkrim*, si dhe neni 8, paragrafi 1 dhe 2 të Rregullores (QRK) nr. 01/2024 për Disiplinën e Nëpunësve Civil, ku përcaktohet se; 1. *Masat disiplinore për shkeljet e lehta shqiptohen nga mbikëqyrësi i drejtpërdrejtë dhe/apo nga udhëheqësi më i lartë administrativ, 2. Zyrtarja/i publik ushtron detyrat e saj/tij dhe vepron me profesionalizëm, paanësi, mos diskriminim, në kohë, pa interes personal dhe në përputhje me legjislacionin në fuqi*, sepse në rastin*

Sekretari i Përgjithshëm i Ministrisë së Punëve të Jashtme dhe Diasporës ankuesit i ka shqiptuar masën disiplinore “Vërejte me shkrim”, sepse ankuesi me datën 28.03.2025, përmes emailit ju ka drejtuar Ambasadës së Republikës Italiane, për procesin e aplikimit për viza akreditim në ambasadë, po ashtu me datë 14.04.2025, ankuesi ka vazhduar komunikim përmes emailit me Ambasadën e Republikës Italiane, në Prishtinë për krijimin e një pozitë të re diplomatike në favorin e tij dhe se z.E.R ka ndërmarr veprime të papërgjegjshme institucionale duke adresuar komunikim zyrtar drejtpërdrejtë jashtë hirakisë dhe kompetencës së pacaktuar pa ndjekur procedurat dhe lidhje zyrtare të komunikimit nga Ministria e Punëve të Jashtme dhe Diasporës.

Nga provat e lëndës konstaton se ankuesi me datë 28.03.2025, ka dërguar emaili të dërguar tek Ambasada e Republikës së Italisë, ku në përmbajtjen e këtij emaili është shkruar se; me lejoni të ju shprehë urimet e mia të nderuar të Ambasadës, suaj dhe të ju njoftojë se jam emëruar për të shërbyer si diplomat në Ambasadën e Republikës së Kosovës në Romë / Republika e Italisë, dhe ju lutemi të bashkangjitur gjeni notën verbale të lëshuar nga Ministria e Punëve të Jashtme dhe Diasporës, Departamenti i Konsullatës për Çështje, Konsullore të Republikës së Kosovës, me qëllimin lehtësimin e procesit të aplikimit për viza akreditim në Ambasadën tuaj dhe se edhe njëherë shfrytëzojë këtë rast për të përsëritur Komplotimet për Ambasadën e Republikës së Italiane në Prishtinë dhe shprehi mirënjohje time të sinqertë paraprakisht për mbështetjen time që mundë të jap gjatë këtij procesi, ndërsa ankuesi edhe përmes emailit të dërguar me datë 14.04.2025, dërguar Ambasadës së Republikës së Italisë, në Prishtinë ku në përmbajtjen e këtij emaili është shkruar se; Duke ju referuar Notës Verbale të lëshuar nga Ambasada e Republikës Italiane në Prishtinë, bashkangjitur në këtë email , e cila i është dërguar Protokollit të Shtetit të Ministrisë së Punëve të Jashtme dhe Diasporës ju lutemi të bashkangjitur gjeni notën verbale të re nga Departamenti i Punëve të Ministrisë së Punëve të Jashtme dhe Diasporës të lëshuar nga në përputhje me kërkesën e fundit të notës verbale të Ambasadës së Republikës Italiane në Prishtinë, për të krijuar një qëndrim të ri në favorin tim, bazuar në këtë Kolegji i Këshillit konstaton se ankuesi me veprimet e tij lidhur me komunikimin me Ambasadën e Republikës së Italisë, ka vepruar në kundërshtim me dispozitat ligjore në fuqi, neni 28, paragrafi 1, dhe 2 të Ligjit Nr. 08/L-197për Zyrtarët Publik, ku përcaktohet se; *1.Zyrtarja/i publik ka për detyrim të respektojë Kushtetutën, ligjin dhe ka për detyrim të mbroj interesin publik dhe të drejtat dhe liritë themelore të njeriut, 2. Zyrtarja/i publik ushtron detyrat e saj/tij dhe vepron me profesionalizëm, paanësi, mos diskriminim, në kohë, pa interes personal dhe në përputhje me legjislacionin në fuqi, ndërlidhur me nenin neni 31 paragrafi 1 Ligjit Nr. 08/L-197për Zyrtarët Publik, ku përcaktohet se “Detyrimi i përgjegjshmërisë 1. Zyrtarja/i publik duhet të ushtrojë detyrën e saj/tij me përgjegjshmëri dhe mban përgjegjësi të plotë sipas legjislacionit në fuqi, për çdo veprim apo mosveprim të saj/tij në kuadër të detyrave dhe përgjegjësi”.*

Sipas Vlerësimit të Kolegjit për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave Sekretari i Përgjithshëm i Ministrisë së Punëve të Jashtme dhe Diasporës, në rastin e shqiptimit të vërejtjes me numër protokolli 1718 të datës 07.05.2025 ka vepruar në pajtim me dispozitat, Ligjit Nr. 05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, të Ligjit Nr. 08/L-197 për Zyrtarët Publik Rregullores (QRK) NR. 01/2024 për Disiplinën e Nëpunësve Civil, duke vërtetuar drejtë gjendjen faktike dhe bazën juridike, lidhur me rastin e ankuesit E.R, lidhur me komunikim e ankuesit E.R, me Ambasadën e Republikës Italiane në Prishtinë përmes e- mailiave të datës 28.03.2025 dhe datës 14.04.2025, pa njoftuar asnjë nga zyrtarët e nga Ministrisë së Punëve të Jashtme të Diasporës, ashtu siç përcaktohen me dispozitat ligjore në fuqi.

Kështu që për sa me sipër dhe duke u bazuar në dispozitat e nenit 6 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1 dhe nenin 18 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1 të Ligjit Nr. 06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, si dhe nenin 132 paragrafi 2 të Ligjit Nr.05/L-031 për

Procedurën e Përgjithshme Administrative, Kolegji i Këshillit vendosi si në dispozitiv të këtij Vendimi.

Këshillë juridike: Vendimi hyn në fuqi në ditën e nënshkrimit nga Kryetarja e Kolegjit. Pala e pakënaqur e cila pretendon se vendimi i Këshillit nuk është i ligjshëm mund të iniciojë konflikt administrativ në Gjykatën Themelore në Prishtinë/Departamenti për Çështje Administrative, brenda afatit prej tridhjetë (30) ditësh nga dita në të cilën i është dorëzuar vendimi. Inicimi i konfliktit administrativ nuk e ndalon ekzekutimin e këtij vendimi.

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
Lënda: A.nr 1081/2025

Rushit Kajtazi

Procesmbajtës

Eshref Shabani

Kryetar i Kolegjit

Vendimi i dërgohet:

- Ankuesit E.R;
- Udhëheqësit të Burimeve Njerëzore në Ministrinë e punëve të Jashtme dhe Diasporës, dhe
- Arkivit të KPMSHCK-së